REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË 04.02.2022

Me datë 04.02.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër.Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija,Bledianë Nika, Nersada Mandija, Aurora Dibra,Tereze Brixha, Diana Ndreu, Diana Muriqi, Jona Leqejza,Sabahete Lishi, Vjollca Petani, Daniela Jakoja, Ardita Spahija, Dhurata Tyli,Sabina Danaj, Donika Ndoja, Kristi Agnes Shllaku, Diadra Kraja,Suada Selimaj,Lumnije Guri, Erion Metushi, Hilmi Lakti, Julian Kraja, Anton Kaftalli, Avenir Celaj, , Saed Cocja, Gerald Hasaj, Sokol Zaimaj, Besmir Vukaj, Blerim Dimnaku ,Luigj Palushi, Lindita Nika,_Nadir Spahija.

Kourumi i domosdoshëm ndodhet në sallë dhe mbledhja deklarohet e hapur nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Dhjetor 2022".*
2. Pr/ Vendim *"Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato individë/familje që nuk e përbaloojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2022 dhe miratimin e bashkëfinancimit për këtë program.*
3. Pr/ Vendim *"Për emërimin e shkollës së mesme fshati oblikë me emrin Idriz Hoxha"*
4. Pr/ Vendim *"Për një ndryshim në VKB nr.6 datë 30.01.2018 "Për miratimin e nivelit tëp agave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar,të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë,të ndryshuar.*
5. Pr/ Vendim *"Për miratimin e vlerësimit paraprak dhe masës së shpërblimit për shpronësimin për interes public,të pronarëve të pasurive të paluajtshme (truall), pronë private ,që preken për efekt investimi public të objektit rikostruksion rruga e korpusit,bashkia Shkodër. "*
6. Pr/ Vendim *"Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"*

7. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Mbledhja hapet me hedhjen në votim të rendit të ditës, ku rezultojnë 32 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim. ***Miratohet***

1. Mbledhja vijon me Pr/Vendimin *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Dhjetor 2022"*

Relaton Kryetarja e Bashkisë sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës. Kryetarët e grupeve shprehen dakort.Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 33 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

2. Vijohet me Pr/ Vendim *"Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato individë/familje që nuk e përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2022 dhe miratimin e bashkëfinancimit për këtë program.*

Përsëri fjala për znj.Ademi,e cila sqaron dhe relaton në lidhje me Pr/Vendimin e mësipërm në bazë të materialit të përgatitur nga administrata.

Fjala për znj.Mandija,e cila në emër të komisionit të cështjeve sociale shpreh dakortësi. Edhe znj.Dibra në emër të grupit socialist shprehet pro këtij vendimi dhe mbështet komisionet përkatëse.
Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort dhe kërkon të dijë nëse kjo mbështetje do vazhdojë.

Përgjigjet znj.Ademi,dhe shprehet se mbështetja e qeverisë duhet të vazhdojë dhe është kërkuar që ky fond të jepet për më gjatë.Shpresojmë në përgjigje pozitive.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 34 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

3. Vijohet me Pr/ Vendim *"Për emërimin e shkollës së mesme fshati oblikë me emrin Idriz Hoxha"*

Relaton Kryetarja e Bashkisë sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës dhe sqaron që ky Pr/Vendim ka ardhur si propozim i komunitetit të zonës dhe pasi kemi kryer të gjithë procedurën përkatëse ligjore vijmë në këshill me këtë projekt. Emri i z, Idriz Hoxhës vjen si kërkesë e banorëve dhe disa këshillëtarëve sinjë figurë me shumë kontribut.
Z. Lakti falenderon anëtarët e këshillit si propozues të këtij Pr/Vendimi.

Kryetarët e grupeve shprehen dakort. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 34 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

4. Vijohet me Pr/ Vendim *"Për një ndryshim në VKB nr.6 datë 30.01.2018 "Për miratimin e nivelit tëp agave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar,të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë,të ndryshuar.*

Fjala përsëri për Znj.Ademi e cila sqaron se në mbështetje të ligjit për nënpunësin civil dhe akteve ligjore përkatëse kërkohet saktësimi I pagave për nënpunësit civil dhe ato të administratës . Gjithashtu në bazë të një fondi të akorduar për këtë pësojnë ndryshim disa pozicione.Vazhdojmë të respektojmë VKM përkatëse për pagën minimale dhe atë maximale.

Znj.Leqejza në emër të komisionit që ajo drejton shprehet pro.Gjithashtu edhe kryetarët e grupeve shprehin dakortësi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë ٧٦ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

5. Vijohet me *"Për miratimin e vlerësimit paraprak dhe masës së shpërblimit për shpronësimin për interes public,të pronarëve të pasurive të paluajtshme (truall), pronë private ,që preken për efekt investimi public të objektit rikostruksion rruga e korpusit,bashkia Shkodër."*

Kryetarja e Bashkisë relation sipas materialit të përgatitur dhe sqaron se është marr miratimi i të gjithë pronarëve dhe është ndjekur e gjithë procedura ligjore e kërkuar për secilën pronë në fjalë.(detajet gjenden në relacion).
Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve.Znj.Dibra dhe Z.Sokoli shprehen pro këtij Pr/Vendimi.
Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë ٧٦ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

6. Vijohet me Pr/ Vendim *"Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri"*

Përsëri fjala për Znj.Ademi e cila thotë se ky është një vendim i përsëritur por I kthyer nga prefekti.Janë konstatuar mangësi, tashmë të rregulluara nga komisioni i vlerësimit, I cili ka bërë vlerësim dhe verifikim në bashkëpunim me Prefekturën.

Meqënëse është dikutuar dhe herë tjera, diskutime dhe pyetje nuk ka. Kryetarët e grupeve shprehen pro. Kalohet në votim, , ku rezultojnë ٧٦ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

7. Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr Znj.Brixha,e cila kërkon të dijë në lidhje me eksperiencën e këshillëtarëve në Austri,se cfarë bashkëpunimi ishte,etj.

Z.Kaftalli kërkon informacion nga zyra e Kulturës në lidhje me Festivalin e këngës popullore.

Përgjigjet Znj.Ademi e cila thotë se për arsye familjare ajo nuk ka mundur të jetë e pranishme gjatë udhëtimit në Austri, por mendon se shkëmbime të tilla janë gjithmonë të vlefshme. Kurse në lidhje me pyetjen e z.Kaftalli ajo nuk ka një informacion të saktë por shume shpejt do depozitojnë pranë sekretarisë së këshillit një përgjigje të detajuar për këtë.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka.Mbledhja deklarohet e mbyllur.